- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruarat në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se 19% të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij ku të jenë të pasqyruar në **listpagesat sipas formularit Esig 025** të pakten:

1) **1(një)Përgjegjës Teknik** i cili duhet të jetë i profilit inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti. Përgjegjësi teknik mund të jetë edhe drejtuesi ekzekutiv i subjektit. Dhe të paraqitet dokumentacionin si më poshtë:

a)Diploma universitare për inxhinieri mekanike profile transporti, ose diplomë teknike, profil mekanik transporti.

b)Kontrata e punës e noterizuar

c)CV e inxhinierit/teknikut mekanik

d)Dëshmi Aftësie Profesionale të veprimtarisë së autoriparimit (referuar Ligjit Nr.9573, dt.03/07/2006) për nën kategoritë, si vijon:

A- Riparim dhe mirembajtje e pjesëve mekanike dhe të motorrit

C- Riparim dhe mirembajtje impjanti elektrik

Ç- Riparim dhe mirembajtje gomave

2) ***1(nje) motorrist ku te paraqitet:***

- a)Diploma e shkolles se mesme profesionale ose certificate profesionale
- b)Kontrata e punes respektive konform akteve ligjore e noterizuar e vlefshme
- c)CV e motorristit

3) ***2 (dy)xhenerikë ku te paraqitet:***

- a)Diploma e shkolles se mesme profesionale ose certificate profesionale
- b)Kontrata e punes respektive konform akteve ligjore e noterizuar e vlefshme
- c)CV e xhenerikeve

4) ***1(nje) elektroaut ku te paraqitet:***

- a)Diploma e shkolles se mesme profesionale ose certificate profesionale
- b)Kontrata e punes respektive konform akteve ligjore e noterizuar e vlefshme
- c)CV e elektroautit
- d)Deshmi kualifikimi e sigurimit teknik

5) ***1(nje) pompist ku te paraqitet:***

- a)Diploma e shkolles se mesme profesionale ose certificate profesionale
- b)Kontrata e punes respektive konform akteve ligjore e noterizuar e vlefshme
- c)CV e pompistit

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

- Vertetimi i pagesave të sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga Tatim Taksat është detyrim ligjor për çdo llojë biznesi.
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatori ekonomik të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e tij, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht referuar llojeve të mjeteve, natyrës së shërbimeve, numrit të madh të mjeteve që kërkohen të mirëmbahen (siç janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, të sistemeve elektrike, elektronike, drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj). Lidhur me këto shërbime është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë të punësuar në stafin e tij punonjës të kualifikuar si (motorrist, xhenerik dhe elektroauto), me qëllim realizimin e shërbimeve objekt kontrate. Emërtimi i profesioneve është bërë në përputhje me VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar.

Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, kushtet teknike dhe zërat e shërbimit që kërkohet. Nevoja për inxhinier mekanik është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbime të ngjashme. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 6 (Gjashtë) punonjës ndër të cilët të jete pjesë dhe stafi teknik për periudhën Janar 2023

Ne lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- Vertetim nga Administrata Tatimore ose Dega e Sigurimeve Shoqërore për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar 2023.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, referuar llojeve të mjeteve, natyrës së shërbimeve, numrit të madh të mjeteve që kërkohen të mirëmbahen (siç janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, të sistemeve elektrike, elektronike, drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj).

Kërkesa e mësipërme i referohet numrit minimal të parashikuar prej 6 (gjashtë) personash (1 (një) inxhinier mekanik), (1 (një) motorrist), (2 (dy) auto-xhenerikë), (1 (një) elektroaut), (1 (një) pompist). Numër ky minimal punonjësish për kryerjen e shërbimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të **kete ambjent ne pronesi ose me qera për kryerjen e shërbimit** dhe të zotërojë makineri dhe pajisje te nevojshme per realizimin e kontrates, si me poshte:

a) Reparti Elektroaut

- 1 (nje) paisje bango prove per motorrine dhe dinamo
- 1 (nje) paisje diagnostikuese te difektit ne automjet.
- 1 (nje) pajisje te levizshme (portabile) per ndezje emergjente te mjetit 12v & 24v.
- 2 (dy) paisje per kontrollin dhe komprimin e gazit te A/C
- 1 (nje) paisje per rregullimin e ndricimit te automjeteve

b) Reparti Motorist

- 1 (nje) paisje per venien ne faze se motorrit
- 1 (nje) paisje per retifikimin e testates se automjeteve
- 1 (nje) paisje për kontrollin e bllokut të cilindrit të motorit dhe testatove (për çarje)
- 1(nje) paisje bango prove per riparimin e pompave dhe injatoreve

c) Reparti Xhenerik/Mekanik

- 1 (nje) paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit te automjetit
- 1 (nje) paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit te amortizimit te automjetit.
- 1 (nje) paisje per kontrollin dhe testimin e difekteve (xhokove) ne sistemin e drejtimit.
- 1 (nje) paisje per kontrollin dhe testimin e gazrave te automjetit
- 1 (nje) paisje per sistemin e kontrollit dhe dedektimin te rrjedhjes se sistemit te ftohjes te automjetit(radiatorit dhe pjeseve perberese te tij)
- 2 (dy) grupa per riparimin e difekteve te automjeteve

d) Reparti Saldimit

- 1 (nje) paisje per saldim me oksigjen dhe acitilen
- 1 (nje) paisje per saldim me argon
- 1 (nje) paisje per saldim me elektrik

- a. Për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Neneve: Neni 41, pika 4/ç, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion 1 (një) ambjent/servis për realizimin/ekzekutimin e shërbimeve objekt prokurimi. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve është vlerësuar e domosdoshme/nevojshme që operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtrojnë aktivitetin e tyre me qëllim realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. **Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pajisje të cilat janë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

Ky kriter është vendosur në mënyrë që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme organizative, për të zbatuar dhe për të përmbushur kontratën në përputhje me specifikimet dhe standardet e kërkuara nga Autoriteti kontraktor dhe nisur nga shumëllojshmëria e mjeteve, specifikat e veçanta të tyre dhe numri i mjeteve për mirëmbajtje.

Bazuar ne ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar. Ambientet e ushtrimit të aktivitetit në pronësi ose me qera të jene të pasqyruara në Ekstraktin e QKB-së.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Licencen VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” per 3 (tre) pikat a,c,ç të lëshuar nga QKB në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe

Infrastrukturës, me nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. (Licensa e me sipërme e kërkuar lëshohet nga QKB, licensa është e lidhur ngusht me objektin e prokurimit, bën pjesë në fushën e mirëmbajtjejs (riparimit) të mjeteve rrugore, dhe kërkesa në fjalë i referohet kapaciteteve të cilat zotrohen nga OE pjesëmarrës në procedure të cilët tregojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme për kryerjen me cilësi të shërbimit.)

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **certifikatat** e mëposhtme:

- **ISO 9001:2015** Certifikata e sistemit të menaxhimit të cilësisë
- **ISO 45001:2018** Certifikate e sistemit menaxhial të shëndetit dhe sigurisë në punë

ISO 9001:2015

ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit.

Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve.

Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar. Mbajtja e certifikimit sjell disa përparësi për shoqërinë siç janë: akses tek procedurat e tenderave publike, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

ISO 45001:2018

Çdo kompani ka detyrimin të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit.

ISO 45001 është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Certifikimi ISO 45001 mund të merret nga çdo kompani, pavarësisht aktivitetit të saj si dhe risqeve të shëndetit dhe sigurisë.

Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër në ambientet e saj.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a, nenin 79 të LPP, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) i përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatorët pjesëmarrës të provojnë se kanë një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tyre për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te kete karrotrec per transportimin e automjeteve te difektuara.

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese dokumenta qe vertetojne se ka karrotrec ne pronesi ose me qera si dhe dokumentat e nevojshem per qarkullimin e mjetit (Leje qarkullimi,Kolaudim,Siguracion, Leje per transport)

- Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin", për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. AK kërkon që OE duhet të disponojë një automjet karrotrec, i cili do të jetë i nevojshëm nëse ndonjë prej automjeteve të AK gjatë aktivitetit ditor pëson ndonjë defekt të mundshëm dhe si pasojë lind nevoja për dergimin e mjetit të servisi i OE kontraktor.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një **deklarate për garancinë e mallit** (pjesët e këmbimit të cilat do të zëvendësohen mjeteve) si dhe të shërbimit të ofruar jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Neni 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Kërkesa në fjalë është një garanci dhe i jep siguri AK se OE do të kryejë shërbimet e kërkuara me cilësi dhe saktësi, dhe se do të mbajë përgjegjësi për shërbimet e kryera edhe pas përfundimit të shërbimit, referuar afateve të vendosura nga AK për ekzekutimin e kontratës.

2.3.9 Operatori ekonomik **duhet të plotësojë një tabelë** ku të shënohet kodi i pjesës që do të zëvendësohet me qëllim verifikimit të pjesës ose pjesëve.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Neni 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Ky kriter shërben si garanci për AK se lloji pjesëve të cilat do të vendosen do të jenë të përshtatshme për mjetet për të cilat kërkohet shërbimi. Gjithashtu kërkesa në fjalë shërben si informacion i cili do të përdoret si mjet verifikimi, për të vërtetuar se pjesët e këmbimit janë origjinale ose ekuivalente.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, **janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit.** Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website (nëse ka), kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Neni 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Kriteri në fjalë i shërben AK për të vërtetuar se pjesët e këmbimit janë cilësore, origjinale apo ekuivalente. Nëpërmjet plotësimit të këtij kriteri OE pjesëmarrës vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për ekzekutimin në mënyrë të sukseshme të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punes referuar praktikës së miratuar nga titullari i AK, bazuar në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, , nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar

Pas finalizimit të këtij procesi për përgatitjen e specifikimeve teknike, grupi i punes, bazuar në nenet 34 dhe 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 12, 13 , nenin 45 pika 2 dhe neni 76 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, filloj punën për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës objekt prokurimi, bazuar pikës b/ të nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të referohet një ose më shumë alternativave dhe konkretisht AK i është referuar neni 76 germa “b” e renditur si më poshtë:

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga studim.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve : Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Tiranë kërkon të mirëmbajë mjetet e transportit për një periudhë 25 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Detyrat : Operatori i cili do të rezultojë fitues, me marrjen e kërkesës nga Autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Tiranë, do të dorëzojë një ofertë për shërbimin e kërkuar.

- Shërbimi i kërkuar do të ofrohet sipas kërkesës të AK Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Tiranë , nga lidhja e kontratës me afat ekzekutimi 25 ditë. Çdo mjet do shoqërohet me autorizim nga Autoriteti kontraktor për riparimin e tij.

- Zërat e punës për çdo mjet janë parashikuar referuar në gjendjen teknike të mjeteve, kilometrat e përshkruara dhe detyrat e planifikuara. Përpara riparimit defektet e parashikuara duhet të confirmohen nga kontraktori në prezencë të përfaqësuesit të Autoritetit kontraktor.

- Në rast të mosplotësimit të kohës së garancisë (jo më pak se 12 muaj) nga cilësia e keqe e pjesëve të montuara ose punës së kryer për montimin e tyre, riparimi do të përsëritet me shpenzimet e Operatorit Ekonomik fitues.

- Ofertuesi angazhohet në kryerjen me cilësi të shërbimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, sipas garancisë së kërkuar.

- Për çdo shërbim të kryer Operatori Ekonomik fitues duhet të lëshojë stacionin e riparimit të mjetit.

Shpërndarja: Nga momenti i lidhjes së kontratës, deri në përfundim të saj dhe dorezimit të mjeteve të riparuar Autoritetit Kontraktor.

Vendi i kryerjes së shërbimeve : Në Autoservisin e operatorit ekonomik fitues.

Angazhimi i karrotrecit : Shërbimet e karrotrecit do të kërkohen nga AK dhe do të afrohen pa pagesë nga OE fitues, në rastin e pamundësisë teknike të levizjes së automjeteve të difektuara.

NJËSIA E PROKURIMIT: